**V E N D I M**
**Nr. 520, datë 12.8.1996**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.276, DATË 30.6.1992 "PËR ORGANIZIMIN, PRITJEN, SHPËRNDARJEN DHE ADMINISTRATIMIN E NDIHMAVE SHTETËRORE" DHE NDRYSHIMEVE TË TIJ INDUSTRISË, TRANSPORTIT DHE TREGTISË, SI DHE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE USHQIMIT, KËSHILLI I MINISTRAVE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së

V E N D O S I :

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.276, datë 30.6.1992 "Për organizimin, pritjen, shpërndarjen dhe administrimin e ndihmave shtetërore", vendimi nr. 479, datë 16.9.1993, vendimi nr.512, datë 26.10.1993, vendimi nr.598, datë 20.12.1993, vendimi nr.35, datë 7.2.1994, vendimi nr.175, datë 25.4.1994, vendimi nr.293, datë 30.6.1994, vendimi nr.383, datë 15.8.1994, vendimi nr.58, datë 30.1.1995 dhe vendimet e tjera që bëjnë ndryshime në vendimin nr.276, datë 30.6.1992, ose kanë lidhje me të, shfuqizohen.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe BGT-së në Durrës u njihen detyrimet e mbetura ndaj fondit kundërparti të buxhetit të shtetit, të krijuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.276, datë 30.6.1992, me ndryshimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**